



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr. 3052 Prot.

Ballsh, më 21.06.2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. 23 /datë: 21 / 06 / 2024

PËR

MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM 2025-2027

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë:

Të miratoj:

1. Projekt dokumentin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 .
2. Bashkalidhur Drafti i PBA 2025-2027 dhe relacioni.

Në bashkëpunim me ju!

Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale

Aleksander Rama

Drejtori i Drejtorisë Juridike

Laureta Saliq

KRYETAR

Qerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr. 3052/1 Prot.

Ballsh, më 21.06.2024

RELACION

PËR

DOKUMENTIN DOKUMENTIN E PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM 2025-2027.

**I. Vështrim i Përgjithshëm**

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për parashikimin e shpenzimeve për periudhën afatmesme duke garantuar kontrollin e shpenzimeve; vlerësimin e politikave ekzistuese dhe parashikimin e politikave të reja; zhvillimin e strategjive; lidhjen e qëllimit të programit buxhetor me objektivat, produktet dhe veprimtaritë. Parakusht për përgatitjen e parashikimit të shpenzimeve është konsensusi i gjërë për përcaktimin e prioriteteve të politikave dhe objektivave në nivel të matshëm. Parashikimi i shpenzimeve afatmesme fillon me vlerësimin e nivelit aktual të shpenzimeve; shpenzimet për të njëjtin nivel dhe cilësi shërbimi; shpenzimet që vijnë nga kursi i këmbimit dhe politikat e pagave; dhe vlerësimi i shpenzimeve për politikat e reja. Parashikimi afatmesëm i shpenzimeve rrit: kontrollin e shpenzimeve dhe shpërndarjen e burimeve nën një kontroll të fortë buxhetor; mbikqyrjen e shpenzimeve të ardhshme; identifikimin e programeve të reja buxhetore; planifikimin dhe menaxhimin e investimeve kapitale; parandalimin e shkurtimit të shpenzimeve kapitale nga presioni i shpenzimeve korrente; kontrollin e shpenzimeve në të ardhmen, për të garantuar stabilitet fiskal dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social.

**I. Parashikimi i shpenzimeve**

Për realizimin e parashikimit të shpenzimeve Bashkia Mallakastër ka përdorur Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor. Parashikimi i shpenzimeve është kryer sipas klasifikimit të programeve buxhetore dhe produkteve të përcaktuara në Shtojcën 4, të Udhëzimit Nr.3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", të Ministrit të Financave (Udhëzimi 3/2024). Parashikimi i shpenzimeve është kryer brenda kontekstit fiskal të Bashkisë. Shpenzimet janë parashikuar mbi bazë produktesh, të parashikuara për çdo program buxhetor për arritjen e objektivave të programit buxhetor.

## II. Lista e Programeve të Bashkisë

- 01110 Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi
- 03140 Shërbime policore
- 03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile
- 04240 Menaxhimi i Infrastruktues së Ujitjes dhe Kullimit
- 04260 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave
- 04520 Rrjeti Rrugor Rural
- 05100 Menaxhimi i Mbetjeve
- 06260 Shërbimet Publike Vendore
- 08130 Sport dhe Argëtim
- 08220 Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore
- 09120 Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin
- 09230 Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm
- 10430 Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Për garantimin e zbatimit të kompetencave, zgjidhjen e problemeve të komunitetit dhe ofrimin e shërbimeve publike, si edhe realizimin e prioriteteve, brenda fushave të përgjegjësisë, ka parashikuar zhvillimin e 13 programeve buxhetore.

**I. Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën afatmesme**  
Vërejmë se, bashkia Mallakastër ka parashikuar një rritje të të ardhurave të përgjithshme me 5% në vitin 2025, nga pritshmëritë e vitit 2024; me një rritje prej 3% në vitin 2026; me një rritje prej 3% në vitin 2027. Ka parashikuar një rritje të të ardhurave nga burimet e veta me 3% në vitin 2025, nga pritshmëritë e vitit 2024; me një rritje prej 3% në vitin 2026; me një rritje prej 3% në vitin 2027.

Viti	mijë lekë				
	2023	2024	2025	2026	2027
Të ardhurat e përgjithshme		804,123	840,811	868,546	898,351
Të ardhurat nga burimet e veta		385,039	396,589	408,488	420,743
Të ardhurat nga taksat e ndara		26,006	26,787	27,591	28,419
Të ardhurat nga taksat e veta		156,830	161,535	166,381	171,373
Të ardhurat nga tarifat		224,071	230,792	237,717	244,848

Si dhe është pasqyruar në tabelën e mësipërme, të ardhurat nga burimet e veta janë parashikuar të zënë 47.1% të të ardhurave të përgjithshme në vitin 2025; 47% në vitin 2026; dhe 46.8% në vitin 2027. Niveli fakti i të ardhurave nga burimet e veta, të vitit 2023, nuk janë pasqyruar në PBA. Në

vitin 2024 të ardhurat nga burimet e veta janë parashikuar të zënë 47.7% të të ardhurave të përgjithshme.. Për konsolidimin e autonomisë fiskale bashkia duhet të rrisë shkalën e realizimit të të ardhurave nga burimet e veta.

Burimet e të ardhurave buxhetore janë shpërndarë në 13 programe buxhetore. Si dhe vihet re, në tabelën e mëposhtme, niveli më i lartë i fondeve është parashikuar tek: programi buxhetor 04520-Rrjeti rrugor rural, ku në vitin 2025 janë parashikuar që fondet për këtë program të zënë 37.6% të totalit të fondeve të parashikuara; të zënë 37.5% në vitin 2026; dhe 37.3% në vitin 2027; programi buxhetor 01110-Planifikim, Menaxhim, Administrim, janë parashikuar të zënë 18.8% në vitin 2025; 18.9% në vitin 2026; 19.1% në vitin 2027; programi buxhetor 09120-Arsimi bazë përfshirë parashkollorin, janë parashikuar të zënë 13.9% në vitin 2025; 13.9% në vitin 2026 dhe 2027 të pandryshuar. Niveli më i ulët i fondeve të parashikuara janë tek: programi buxhetor 08130-Sport dhe Argëtim, ku janë parashikuar të zënë 0.06% në vitin 2025; 0.07% në vitin 2026; dhe 0.07% në vitin 2027; programi buxhetor 10430-Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, ku është parashikuar të zënë 0.64% në vitin 2025; 0.62% në vitin 2026; dhe 0.62% në vitin 2027. Synohet që, në shpërndarjen e burimeve buxhetore përparësi duhet dhënë programeve buxhetore që ofrojnë kujdesin social ndaj komunitetit, sportit dhe argëtimit dhe uljen e shpenzimeve administrative.

Përqindja e fondeve të programit ndaj totalit të fondeve vjetore në PBA-në 2025-2027				
Kodi	Titulli I Programit/ Viti	2025	2026	në %
				2027
01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	18.8	18.9	19.1
03140	Shërbime policore	1.4	1.4	1.4
03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	2.7	2.8	2.7
04240	Menaxhimi i Infrastruktës së Ujitjes dhe Kullimit	2.3	2.3	2.3
04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	1.3	1.4	1.4
04520	Rrjeti Rrugor Rural	37.6	37.5	37.3
05100	Menaxhimi i Mbetjeve	6.9	6.9	6.9
06260	Shërbimet Publike Vendore	10.2	10.6	10.2
08130	Sport dhe Argëtim	0.06	0.07	0.07
08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	2.3	2.3	2.3
09120	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	13.9	13.9	13.9
09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	1.4	1.4	1.4
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	0.64	0.62	0.62

Në total rezulton me një rritje të parashikimit të shpenzimeve me 5% në vitin 2025, nga buxheti fiskal i vitit 2024; me një rritje prej 3% në vitin 2026; dhe me një rritje prej 3% në vitin 2027.

#### Shpenzimet e personelit (600+601)

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore zënë 46.4% të totalit të shpenzimeve në vitin 2025; 46.4% në vitin 2026; 46.4% në vitin 2027. Në buxhetin fiskal të vitit 2024 janë parashikuar të zënë 46.5%. Niveli i shpenzimeve për personelin është i pandryshuar në tre vitet e PBA-së parashikohet ulja e shpenzimeve për pagat dhe sigurime shoqërore dhe , duhet të bëjmë rritjen e shpenzimeve kapitale.

#### Shpenzimet Operative (602-606)

Shpenzimet operative zënë 27.5% të totalit të shpenzimeve në vitin 2025; 27.5% në vitin 2026; 27.5% në vitin 2027. Në buxhetin fiskal, të vitit 2024, janë parashikuar të zënë 27.5%.

## **Shpenzimet për Investime (230-231)**

Shpenzimet për investime zënë 25.9% të totalit të shpenzimeve në vitin 2025; 25.9% në vitin 2026; 25.9% në vitin 2027. Në buxhetit fiskal, të vitit 2024, janë parashikuar të zënë 25.9%.

Vërejmë se, niveli i shpenzimeve kapitale ka një konstante të parashikimit në tre vitet në vazhdim. Rritja e shpenzimeve për investime dhe realizimi i tyre sipas planeve strategjike të zhvillimit krijon kushte për zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë; rritjen e cilësisë së shërbimeve..

### **II. Shpenzimet e programeve me produkte dhe Pema e programit**

Bashkia ka parashikuar shpërndarjen e burimeve për 13 programe buxhetore dhe për çdo program buxhetor ka parashikuar Qëllimin e Programit; Treguesit e Performancë; Objektivat; dhe 1-Produkt për çdo program buxhetor. Shpenzimet për produktint janë parashikuar brenda vlerës së tavanit buxhetor.


### **III. Projektet prioritare të investimeve në periudhën afatmesme**

Si edhe pasqyruam më lart, rritja e fondeve për investime duhet të jetë prioritet i bashkisë. Rritja e fondeve për investime do të çojë në garantimin e shërbimeve cilësore, rritjen e potencialeve të zhvillimit ekonomik, dhe arritjen e prioriteteve strategjike. Në SMBV, fondet për investime janë pasqyruar në nivel projekti për çdo program buxhetor.

**Prioritetet në planin e investimeve janë:**

- **Rehabilitimi i rrugëve**
- **Rikonstruksioni i shkollave**
- **Ndërtimi i vendgrumbullimit të mbetjeve urbane**
- **Blerje paisje dhe mjete pune.**

Drejtori Drejtorise Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale  
Aleksander Rama



**KRYETAR**

**Qerim ISMAILAJ**

